



REPubLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET
PER
KTHIMIN E LIGJIT NR. 8811, DATE 17.05.2001
“ PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KESHILLIT TE LARTE TE DREJTESISË “

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr 8811, datë 17.05.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë “”

Tiranë, më 14.06.2001
Nr i dekretit 3061



PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI

*2.8.06/01
Rexhep Meidani*

15/06/01

MOTIVIMI
I
KTHIMIT TE LIGJIT NR. 8811, DATE 17.05.2001
“ PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KESHILLIT TE LARTE TE DREJTESISË ”

Të nderuar deputetë!

Në datë 31 maj 2001, më është paraqitur për shpallje ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Duke konstatuar në këtë ligj formulime që krijojnë dyzime lidhur me disa parime të formuluar qartë në Kushtetutë, por që sjellin dhe një shmangie nga praktika e deritashme bazuar e ndërtuar mbi vetë Kushtetutën, por dhe në ligjin bazë të organizimit të sistemit të drejtësisë të derivuar prej saj, mbas disa konsultimeve të zhvilluara, ligjin vendosa të mos e shpall, por ta kthej edhe njëherë për shqyrtim në Kuvend.

Unë gjykoj se formulimet e neneve 16 dhe 31 të këtij ligji vijnë ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e vecanërisht me nenet 7, 137 e 147 të saj.

Sipas neneve 137 e 147 të Kushtetutës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organi që vendos për përgjegjësinë disiplinore, shkarkimin nga detyra, pamjaftueshmërinë profesionale, apo lejimin e procedimit penal për gjyqtarët e shkallës së parë dhe atyre të apelit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas Kushtetutës drejtohet nga Presidenti i Republikës dhe në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari i KLD-së. Ky i fundit, po sipas Kushtetutës, është edhe autoriteti përgjegjës për organizimin e veprimtarisë së KLD-së. Pra të vetmit figura me detyra të përcaktuara nga Kushtetuta në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, janë Kryetari dhe Zëvendëskryetari.

Në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, në ligjin që më ka ardhur për shpallje, roli i Ministrit të Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në momente të caktuara, është më i lartë se ai i anëtarëve të tjerë. Kështu, ai është i vetmi që ka të drejtën e vlerësimit nëse duhet filluar apo jo procedimi ndaj një gjyqtari. Një qëndrim i tillë mendoj se vjen ndesh me nenin 147, pikat 4 dhe 6, të Kushtetutës, në të cilën është parashikuar kompetenca e KLD-së që të marrë masa disiplinore sipas ligjit, apo të shkarkojë gjyqtarët, pa u ndërvarur kjo e drejtë nga ndonjë organ tjetër. Prandaj do të gjykoja që vetë KLD-ja, krahas Ministrit të

Drejtësisë, kur konstaton se në veprimet e një gjyqtari të shkallës së parë apo të apelit ndeshen veprime që justifikojnë marrjen e masave disiplinore, të mos ketë asnjë pengesë për të filluar procedimin disiplinor.

Të deruar deputetë !

Me ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “ Për organizimin e pushtetit gjyqsor në Republikën e Shqipërisë “, në zbatim të parimit kushtetues të pavarësisë së pushtetit gjyqsor, për herë të parë u ngrit Inspektoriati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përbërja e të cilit u përzgjedh nga radhët e magistratëve më të kualifikuar. Gjatë këtyre viteve ky inspektoriat u krijua, organizua dhe gradualisht krijoi fizionominë e tij në drejtim të inspektimit të gjykatave duke ruajtur pavarësinë e gjyqtarëve, dhe duke kontribuar në rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë së tyre.

Por, ndërsa pritej që të ndërmereshin nisma për konsolidimin e mëtejshëm të tij, me miratimin e ligjit “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë “ të krijohet mendimi i zhvillimit të një procesi të kundërt. Sipas neneve 16 dhe 31 të këtij ligji, detyra e inspektimit të gjyqtarëve i hiqet këtij inspektoriati, dhe paralel me të krijohet inspektimi pranë Ministrisë të Drejtësisë, duke marrë funksionet bazë të inspektoriatit të KLD-së. Unë mendoj se një veprim i tillë bie ndesh me frymën e Kushtetutës, neni 7 i saj, si dhe me parimet ndërkombëtare të pranuar edhe nga vendi ynë, në të cilat theksohet parimi i vetkontrollit të gjyqsorit. Kontrolli i gjyqtarëve nga struktura të pushtetit ekzekutiv, sic është drejtorja e inspektimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke shmangur kontrollin e gjyqtarëve nga inspektorët e KLD-së, të cilët janë me status gjyqtari, përbën qoftë dhe në trajtë të zbehtë një ndërhyrje të pushtetit ekzekutiv në atë gjyqsor, e për pasojë mund të krijojë premisa për të cënuar pavarësinë e gjyqsorit. Prandaj, do të sygjeroja, që duke konsoliduar përvojën e fituar këto vitet e fundit mbas miratimit të Kushtetutës, të bëhen përmirësimet e nevojshme të neneve 16 dhe 31 të ligjit, në sensin e dhënies së prioritetit dhe fuqizimit strukturor të rolit të inspektoriatit të KLD-së në kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve.

Duke shprehur në mirëkuptimin Tuaj



**PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI**

Rexhep Meidani